

E drejta për informim

Newsletter mujor mbi mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për të Drejtën e Informimit

Newsletter është publikim i Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale

Fokusi i muajit

**Strategjia Institucionale e KDIMDP
2022 - 2025**

Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale prezantoi Strategjinë Institucionale 2022-2025, në përmblyllje të procesit të konsultimit publik për këtë dokument të rëndësishëm të autoritetit.

Strategjia identifikon vizionin dhe misionin e Zyrës së Komisionerit, objektivat për secilën fushë, si dhe masat e aktivitetet konkrete që do të realizohen në këtë periudhë. Strategjia shoqërohet gjithashtu nga Plani i Veprimit 2022-2025, i cili shërben si një instrument programimi dhe monitorimi i aktiviteteve për përmbushjen e çdo objektivi të parashikuar në këtë Strategji. Përmbushja e tyre ka si qëllim rritjen e nivelit të ushtrimit në praktikë të të drejtave kushtetuese nëpërmjet zbatimit të standardeve më të larta rregullatore në fushën e të drejtës për informim dhe atë të mbrojtjes së të dhënave personale.

Strategjia Institucionale 2022-2025 është hartuar në vlerësimin integral e të kombinuar të kuadrit ligjor në fuqi me atë të modernizuar që pritet të miratohet për të dy fushat e përgjegjësisë. Po ashtu, janë marrë në konsideratë edhe rekomandimet/raportet nga organizma evropiane - ndërkombëtare që mbështesin shtetin shqiptar në arritjen e standardeve bashkëkohore për garantimin e të drejtave të qytetarëve, funksionimin e demokracisë dhe zhvillimin ekonomik-shoqëror të vendit. Strategjia Institucionale parashikon objektiva konkrete për secilën fushë, me masa e aktivitete të qarta, si dhe shoqërohet nga Plani i Veprimit.

Strategjia është hartuar me asistencën e ekspertëve të Projektit të Binjakëzimit "Mbështetje institucionit për përafrimin e legjislacionit mbi mbrojtjen e të dhënave personale me acquis-in e Bashkimit Evropian".

Përmbledhje mujore e vendimeve

**VENDIM NR. 29 - BASHKIA
KAMËZ**

**VENDIMET NR. 31 - 39 NDAJ
SHOQËRIVE TREGTARE**

**VENDIM NR. 40 - BASHKIA
TIRANË**

Vendimmarrja e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale

TRANSPARENCA E AUTORITETEVE
PUBLIKE ËSHTË NJË NGA SHTYLLAT
E MIRËQEVERISJES

VIZITONI WWW.IDP.AL

#informim #transparencë #vendim

Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, gjatë muajit tetor 2022, ka dhënë 9 vendime rrëzimi dhe 2 vendime urdhërimi për vënien në dispozicion të informacionit në zbatim të ligjit 119/2014 "Për të drejtën e informimit" (LDI).

Me anë të vendimit nr. 40 datë 25.10.2022, Zyra e Komisionerit ka vendosur pranimin e ankesës ndaj "Bashkisë Tiranë", me objekt "Ankim ndaj refuzimit për dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare". Kërkuesi ka kërkuar informacion mbi numrin e pallateve të ndërtuara në territorin e Bashkisë Tiranë në funksion të procesit të rindërtimit; në cilat zona janë ndërtuar ato; cilat kanë qenë shoqëritë/kompanitë që kanë realizuar ndërtimin e tyre; sa ka qenë kostoja e ndërtimit për secilin pallat; kopje të procedurave të tenderit/tenderave për shpalljen fitues të shoqërive/kompanive për ndërtimin e pallateve; kopje të kontratave të lidhura me shoqëritë/kompanitë për ndërtimin e pallateve; cilat kanë qenë studiot që kanë realizuar projektet për këto pallate; dhe kopje të kontratave të lidhura me studiot të cilat kanë realizuar projektin e pallateve.

Pas përgjigjes së Autoritetit Publik, kërkuesi pretendon se i është kthyer përgjigje për tre pikat e para të kërkesës për informacion. Ndodhur në këto kushte, me pretendimin se është cenuar në të drejtën për informim, i është drejtuar Zyrës së Komisionerit me ankesë, duke i kërkuar ushtrimin e kompetencave që i njeh ligji për rastet e refuzimit të dhënies së informacionit.

Komisioneri pas shqyrtimit paraprak të ankesës, bazës ligjore dhe rrethanave të faktit të paraqitura në të, vlerësoi se ankesa përmbush kriteret formale ligjore, të përcaktuara në nenin 24 të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit" (në vijim "LDI").

Në ndjekje të procedurës për shqyrtimin administrativ të çështjes, si hap paraprak përpara marrjes së vendimit, në përputhje me nenin 10 të ligjit nr. 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë", i cili parashikon: "Organi publik siguron që të gjitha palët dhe persona të tjerë të përfshirë në procedurë të jenë në gjendje të ndjekin dhe të mbrojnë të drejtat dhe interesat e tyre ligjorë në mënyrë sa më efektive dhe të lehtë të jetë e mundur", Zyra e Komisionerit ka kërkuar qëndrimin e Autoritetit Publik, në lidhje me pretendimin e ngritur nga ankuesi, si dhe sqarime në lidhje me disponimin e dokumentacionit të kërkuar.

Autoriteti Publik konfirmon se ka vënë në dispozicion informacionin e kërkuar në kuadër të procesit të rindërtimit dhe se nga verifikimi i kryer nga ana autoritetit publik informacioni gjendet në sistemin elektronik E-leje.

Pas përgjigjes së sipërcituar, kërkuesi ka vijuar ankimin pranë Zyrës së Komisionerit duke ri konfirmuar qëndrimin e reflektuar në ankesë, si dhe duke sqaruar se: "Në përgjigjen e tij, autoriteti publik, na referon marrjen e informacionit në web, në faqen zyrtare të Agjencisë së Prokurimit Publik, duke mos vënë në dispozicion linqet përkatëse të secilës procedurë.(lidhur me pikën 5 të kërkesës). Ndërkohë nuk na informon në lidhje me pikat e tjera të kërkesës...".

Pas konsultimit të legjislacionit përkatës, parashtrimeve të paraqitura nga Autoriteti Publik dhe dokumentacionit të administruar, Komisioneri vlerëson se, qëndrimi i mbajtur nga Autoriteti Publik, nuk është në përputhje me dispozitat dhe parimet e LDI.

Në lidhje me pretendimin e ngritur nga Autoriteti Publik se, informacioni i kërkuar, konkretisht për pikën 5 të kërkesës për informacion, kopje e procedurave të tenderit/tenderave për shpalljen fitues të shoqërive/kompanive për ndërtimin e pallateve, është i disponueshëm në faqen zyrtare të Agjencisë së Prokurimit Publik, Komisioneri vlerëson se ky pretendim nuk qëndron.

Ky qëndrim i Autoritetit Publik vjen në kundërshtim me parashikimet e pikës 2 të nenit 16 të LDI, në të cilën parashikohet se: "Kur informacioni kërkohet në format elektronik dhe ai gjendet në internet, autoriteti publik i tregon menjëherë kërkuesit adresën e saktë të faqes se ku mund të gjendet informacioni...".

Për rrjedhojë, Komisioneri vlerëson se, Autoriteti Publik për vendosjen në dispozicion të informacionit të kërkuar, duhet t'i tregojë ankuesit adresën e saktë në faqen zyrtare të Agjencisë së Prokurimit Publik, në të cilën gjendet informacioni i kërkuar.

Autoriteti Publik, për vënien në dispozicion të informacionit/dokumentacionit të kërkuar, duhet të mbajë në konsideratë parashikimin sipas pikës 6 të nenit 17 të LDI, ku përcaktohet se: "Nëse kufizimi prek vetëm një pjesë të informacionit të kërkuar, pjesa tjetër nuk i refuzohet kërkuesit. Autoriteti Publik tregon qartë pjesët e dokumentacionit përkatës që janë refuzuar, si dhe në bazë të cilës pikë të këtij neni është bërë ky refuzim".

Në përfundim Zyra e Komisionerit vendosi, urdhërimin e Autoritetit Publik, për vënien në dispozicion të dokumentacionit sipas kërkesës për informacion. Autoriteti Publik duhet të vendosë në dispozicion të kërkuesit çdo informacion/dokument, i cili është prodhuar ose mbahet nga ky i fundit në formën e zotëruar, duke mbajtur në konsideratë parashikimin në nenin 17, të ligjit të sipërcituar.

Për më shumë informacion mund të lexoni të plotë vendimet në faqen e KDIMP www.idp.al.

“Ditët e Transparencës” me Autoritetet Publike të Qarkut Durrës

Në qytetin e Durrësit u mbajt takimi i 5-të në kuadër të nismës “Ditët e Transparencës” të Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, me autoritete publike që e ushtrojnë veprimtarinë në këtë qark. Kjo iniciativë zhvillohet në bashkëpunim me ambasadën e Britanisë së Madhe në Shqipëri dhe ka për qëllim nxitjen dhe forcimin e transparencës proaktive të institucioneve dhe ushtrimin në praktikë të të drejtës nga qytetarët për akses në informacionin/dokumentacionin publik.



Në këtë takim morën pjesë Komisioneri, z. Besnik Dervishi, z. Emiljan Jani, Prefekti i Qarkut, z. Gentian Kallmi, Zv/kryetar i Bashkisë Durrës, drejtues dhe përfaqësues të njësisë të vetëqeverisjes vendore, të institucioneve të sistemit gjyqësor, Prokurorisë, Policisë së Shtetit, strukturave rajonale të institucioneve të varësisë, si dhe koordinatorët e tyre për të drejtën e informimit. Në fjalën e tij përshëndetëse, Komisioneri vlerësoi se transparenca dhe llogaridhënia ndikojnë në përmirësimin e ndjeshëm të shërbimeve për qytetarët. “Qarku i Durrësit është nga më të rëndësishmit në funksion të zhvillimit ekonomiko-shoqëror të vendit dhe në këtë këndvështrim, autoritetet publike duhet të paraqesin një standard të lartë të transparencës” – tha z. Dervishi.

Zyra e Komisionerit prezantoi gjetjet e monitorimeve për zbatueshmërinë e detyrimeve që përcaktohen në ligjin nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit” nga autoritetet publike të këtij qarku. Nga konstatimet dhe analiza e situatës kërkohet një angazhim më i madh prej tyre në kuadër të përgjegjshmërisë dhe integritetit, si elemente të rëndësishëm në funksion të transparencës proaktive. Njëkohësisht, duhet t’i kushtohet vëmendje përditësimit periodik të Programit të Transparencës dhe Regjistrisë të Kërkesave dhe Përgjigjeve, ashtu si edhe dinamizëm nga koordinatorët për rritjen e cilësisë së procesit të trajtimit të kërkesave për informacion. Qasja bashkëpunuese me qytetarët apo grupet e interesit do të ndikojë në forcimin e kulturës së transparencës, pjesëmarrjes dhe mirëqeverisjes së institucioneve publike.




Prezantimi i Raportit të BIRN lidhur me të Drejtën e Aksesit në Informacion në Ballkanin Perëndimor

Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale mori pjesë në takimin e organizuar nga BIRN për të prezantuar gjetjet e raportit “E drejta për informim në Ballkanin Perëndimor 2021” e gazetares Shengjyl Osmani Loxha.

Ky raport paraqet gjetjet dhe rendit institucionet e përzgjedhura nga rajoni nga praktikat më të mira tek ato më të këqija, bazuar në transparencën proaktive dhe në aksesin në dokumentacion publik me kërkesë.

Në lidhje me veprimtarinë e Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, ky raport konsideron Zyrën e Komisionerit shqiptar si më aktiv në rajon për monitorimin dhe tërheqjen e vëmendjes së autoriteteve publike për zbatim më efektiv sa i përket transparencës dhe llogaridhënies.



BIRN-i rekomandon autoritetet publike të të gjithë rajonit që të bëjnë më shumë progres lidhur me transparencën proaktive dhe ligjet për të drejtën e informimit duhet të përmirësohen, si edhe të ngrihen sisteme të digjitalizuara për të lehtësuar aksesin në informacion.



Pjesëmarrja në takimin e Komitetit Ekzekutiv të ICIC

Takimi i 6-të i Komitetit Ekzekutiv të ICIC u zhvillua në datën 20 tetor 2022. Në këtë takim Zyra e Komisionerit mori pjesë si e anëtare e Komitetit Ekzekutiv që prej vitit 2021.

Gjatë këtij takimi u diskutua mbi propozimin për ndryshimin e Kartës së Johannesburgut si dhe u miratuan aplikimet për aderim të dy autoriteteve të reja: Autoriteti për të drejtën e informimit të Maqedonisë së Veriut dhe Ombudsmeni Evropian.



Zyra e Komisionerit është pjesë aktive e grupin ndërkombëtar të punës për transparencën që nga faza e konceptimit (ICIC Transparency by Design International Working Group). Është diskutuar mbi dy dokumente, konkretisht objekti i punës së TbD dhe një draft pyetësor i hartuar lidhur me aksesin në informacion i cili do t'i shpërndahet anëtarësisë.

Qëllimi i këtij pyetësori është të mbledhë të dhëna mbi nivelin dhe zbatimin e transparencës, si edhe të identifikojë praktikrat më të mira të transparencës proaktive. Zyra e Komisionerit ka bërë disa komente lidhur me përkufizimin e transparencës në dokument si dhe mbi sfidat që paraqet iniciativa e TbD, si pasja e një ekuilibri në publikimin proaktiv të informacionit për të respektuar dhe mos cenuar të drejta të tjera.

Grupi i punës do të përgatisë një dokument politikash të cilin do ta prezantojë gjatë Konferencës së ardhme të ICIC.